

Policia tre akuza per Paro Lacin

nga AlbaniaSoccer
E premte, 16 Prill 2010 21:36



Policia e kryeqytetit ka deklaruar sot se ka ngritur tre akuza penale ndaj administratorit te klubit te futbollit Partizani pas arrestimit te tij ditën e djeshme.

“Specialistet e Krimeve Seksuale dhe Lirise se Personit realizuan arrestimin ne flagrante te shtetasit Paro Destan Laçi, 42 vjeç, banues ne Tirane”, thuhej ne deklaratën per shtyp nxjere nga policia.

Sipas saj, arrestimi i Paro Laçit, u be sepse me date 11 Prill 2010, ne afersi te vendit te quajtur Shkemb i Kavajes ne qytetin e Durrës, dyshohet se i ka hequr lirine, kanosur dhe me pas e ka qelluar ne pjese te ndryshme te trupit, 31 vjeçarin Sokol Ramazan Ishka, me banim ne Tirane.

Pas arrestimit, policia tha se materialet hetimore te perpiluara ne ngarkim te administratorit te Partizanit Paro Laçi, i kaluan Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane per veprat penale te “Heqjes se pa ligjshme te lirise” “Kanosjes”, “Demtime te tjera me dashje”.

Enea Shtrepi